

## Valmir Berisha: Milani nuk ofroi aq sa duhet per mua

nga AlbaniaSoccer

E martë, 24 Dhjetor 2013 23:35

---



Valmir Berisha tregon se kuqezinjte e Milanit nuk e kane kenaqur financiarisht me oferten e tyre dhe se tani po pret te degjoj te tjera oferta nga skuadra te medha Europiane. Sulmuesi me origjine shqiptare i Halmstad komentoi te rejat e fundit nga merkato. 17-vjeçari pranoi interesimin e Milanit, por shtoi se kuqezinjte nuk kishin rene dakort per shumen e kartonit te tij. Gjithsesi ai tha se ne futboll nuk i dihet se çfare mund te ndodhe. Sulmuesi deklaroi se eshte prane marrjes se nje vendimi pasi shume skuadra interesohen per te dhe se ai duhet t'i shqyrtoje te gjitha ofertat. Mediat suedeze kane shkruar per kete lajm.